



# PRESS RELEASE

22 prill 2024

## UNDP Kosova dhe Partnerët nisin festimet e Ditës së Tokës

Si traditë e vazhdueshme, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, së bashku me Zyrën e Presidentës dhe Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kanë nisur zyrtarisht një sërë ngjarjesh për të festuar Ditën e Tokës, duke shënuar një tjetër hap të rëndësishëm drejt ndërgjegjesimit dhe veprimit për klimën.

Ngjarja e inaugurimit u zhvillua në Kampusin e Universitetit të Prishtinës 'Hasan Prishtina', duke bashkuar partnerët kyç institucional dhe zhvillimor, duke përfshirë Z. Nuno Queirós, Përfaqësues i Përhershëm i UNDP-së, Z. Liburn Aliu, Ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Z. Hajrullah Çeku, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Z. Faton Peci, Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Znj. Arbërie Nagavci, Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, përfaqësues institucional, ambasadorë dhe partnerë të tjerë të dalluar.

Ngjarja kulmoi me zbulimin e instalacionit artistik "Muri apo Premtimi i Prirët", një strukturë e përbërë nga qese plastike të hedhura dhe materiale të tjera të ricikluara, që synon të shfaqë ndikimin e veprimeve njerëzore në premtimin për një të ardhme më të mirë.

Tema globale e Ditës së Tokës sivjet është Planeti kundër Plastikës, dhe instalacioni artistik i krijuar nga Driton Selmani, si pjesë e Projektit global të UNDP-së Premtimi për Klimën, është një paraqitje e fuqishme e kësaj sfide mjedisore. Instalacioni artistik ka një rëndësi të veçantë pasi është zhvilluar së bashku me nxënësit e shkollës. Ashtu si në vitet e mëparshme, ky inaugurim ka shërbyer për të nënvizuar rëndësinë e angazhimit të komunitetit dhe rolin e tij në formësimin e një të ardhmeje të qëndrueshme për planetin tonë.

Instalacioni artistik është pjesë e projektit "Climate Promise", i zbatuar nga UNDP-ja në Kosovë me të cilin ne konfirmojmë përkushtimin për të nxitur iniciativat e ndërgjegjesimit mjedisor dhe qëndrueshmërisë dhe festimi i Ditës së Tokës shërben si një dëshmi e këtij angazhimi.

### Rreth Instalacionit Artistik

Muri ose Premtimi i Prirët është një projekt publik që ngërthen në vete dinamikën komplekse mes njerëzimit dhe natyrës. Teksa kalojmë nëpër të, ky mur na inkurajon të reflektojmë mbi ndërgjegjesimin mjedisor dhe nevojën urgjente për praktika kolektive të qëndrueshme. Kjo strukturë, e përbërë nga qese të plastikës, të përdorura, dhe materiale të tjera të ricikluara, do të finalizohet me punimet artistike të fëmijëve; premtimet e tyre ndaj Planetit Tokë. Instalacioni u vendos në Kampusin e Universitetit të Prishtinës dhe do të qëndrojë aty nga 22 prilli deri më 5 maj, e pastaj do të shpërbëhet në pjesë më të vogla dhe do të rimodifikohet për ekspozim në disa institucione. Kjo është bërë e mundur falë dizajnit të tij qarkor dhe të qëndrueshëm.

# PRESS RELEASE



25  
YEARS  
KOSOVO

## Rreth Autorit

Driton Selmani është një artist nga Kosova, veprat e të cilit janë ekspozuar në mbarë botën. Selmani zbërthen normat shoqërore, të ushqyera nga skepticizmi i përjetshëm. Arti i tij riimagjinon besimet mes ndryshimeve kulturore, veçanërisht tranzicionit të pafund të vendit të tij të lindjes. Si vëzhgues dhe pjesëmarrës, ai gërsheton historinë personale në krijimet e tij.

## Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni:

Burbuqe Dobranja, zyrtare për komunikim pranë UNDP-së

Telefon: (038) 249 066 lok. 410; mobil: 049 720 800 e-mail: [burbuqe.dobranja@undp.org](mailto:burbuqe.dobranja@undp.org)

Danijela Mitić, zyrtare për komunikim pranë UNDP-së

Telefon: (038) 249 066 lok. 412; mobil: 049 720 824 e-mail: [danijela.mitic@undp.org](mailto:danijela.mitic@undp.org)

-

*Këtë vit shënojmë 25 vjetorin e punës sonë në Kosovë. Gjatë çerekshkullit të kaluar, UNDP-ja ka mbështetur përpjekjet e Kosovës për të arritur Objektivat e Mijëvjeçarit dhe të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Ne do të vazhdojmë të punojmë përkrah institucioneve dhe popullit të Kosovës për të mos lënë askënd pas dhe për të arritur një të ardhme më të mirë për të gjithë.*